



10 gjëra që duhet të dihen për të bartur numrin tuaj:

1. Numrat e telefonisë së lëvizshme NUK MUND të barten tek rrjetet e telefonisë fikse, apo e anasjelltas.
2. Nëse përdorni një kartë të parapaguar, krediti i mbetur nuk mund të transferohet.
3. Procesi për bartje nisët nga pajtimtari. Pajtimtari kontakton Abissnet (operatorin Marrës) dhe shpreh me shkrim vullnetin për të lidhur kontratë/përfituar shërbime prej tij dhe për të bartur numrin e caktuar.
4. Pajtimtari NUK MUND të heqë dorë nga kërkesa për bartje të numrit pasi ka plotësuar formularin dhe kërkesën për bartje tek operatori marrës.
5. Ju duhet të plotësoni kërkesën standarte për bartjen e numrit tek Abissnet (operatori marrës), bashkë me një kopje të kartës së identitetit. Nëse ju dërgoni një person tjetër, duhet ta pajisni me prokurë apo autorizim.
6. Caktoni me operatorin tuaj të ri datën që ju dëshironi të bartni numrin – Koha e aktivizimit të numrit të portuar nuk duhet të jetë më e gjatë se 24 orë nga koha e dërgimit në sistem të kërkesës nga Operatori Marrës.
7. Ndërkohë që keni dërguar kërkesën për bartjen e numrit tek Abissnet, mos dërgoni kërkesa për bartjen tek operatorë të tjerë! Zgjidhni vetëm një operator marrës dhe plotësoni kërkesën vetëm tek operatori përkatës.
8. Për pajtimtarin procesi i portabilitetit të numrit të numrit është pa pagesë.

Kur mund të bart numrin tim?

Numri juaj mund të bartet **kurdo që ju e kërkon**, duke plotësuar kushtin që të kenë kaluar minimalisht **3 muaj nga bartja e numrit në rrjetin e operatorit aktual që dëshironi ta ndryshoni**. Ju duhet të vendosni për të hequr dorë nga shërbimi i një operatori të caktuar dhe të përdorni rrjetin e Abissnet. Çdo numër telefoni mund të bartet, duke ruajtur llojin e rrjetit: një numër telefoni i qëndrueshëm mund të bartet te një rrjet tjetër i qëndrueshëm.

Kujdes: Ndërrimi te një operator tjetër nuk përfundon detyrimet kontraktore të mëparshme.

Transferimi tek Abissnet nuk ju shkarkon nga zbatimi i detyrimeve të kontratës së përfunduar me operatorin aktual. Ju duhet të paguani të gjitha detyrimet që keni nga kontrata e mëparshme. Nëse ka një detyrim para anulimit të kontratës, ju duhet të paguani penaltetet ose të prisni afatin e përfundimit të kontratës para bartjes së numrit dhe ndryshimit të ofruesit të shërbimit.



Sa kushton bartja e numrit ?

Kosto e bartjes së numrit mbulohet nga Abissnet dhe nuk paguhet nga pajtimtari.

Hapat që duhet të ndiqni për bartjen e numrit

- Fillimisht, kur vendosni të ndryshoni operatorin aktual dhe të bartni numrin tuaj në Abissnet, ju duhet të paraqiteni pranë pikave të shitjes Abissnet.
- Pasi të kryhet identifikimi dhe informimi juaj në lidhje me procedurën e bartjes, ju do të plotësoni kërkesën dhe formularin tip për bartjen e numrit. Ju nuk mund të hiqni dorë nga kërkesa për bartje të numrit, pasi të keni plotësuar formularin dhe kërkesën pranë Abissnet.
*Formulari dhe kërkesa mund të aksesohen në linkun e mëposhtëm:
http://www.portabiliteti.al/Formular_per_bartjen_e_numrit.pdf
- Për të pasur mundësinë e bartjes së numrit ju duhet të plotësoni dy kushte, si më poshtë:
 - **Duhet të zotëroni një numër telefonik aktiv** - “Numër Aktiv” është një numër i cili e ka të aktivizuar shërbimin telefonik pra që mund të dërgojë dhe/ose marrë thirrje apo mesazhe komunikimi nëpërmjet rrjetit fiks të operatorit me të cilin pajtimtari ka një kontratë pajtimi të vlefshme (me mënyrë pagese paspagim dhe/ose parapagim).
 - Juve ju lind e drejta e bartjes të numrit vetëm pasi kanë kaluar minimalisht **3 muaj pas bartjes së numrit në rrjetin e operatorit aktual që dëshironi ta ndryshoni.**
- Kur vendosni të bartni numrin tuaj, duhet të keni parasysh elementet e mëposhtme:
 - **Numrat e telefonisë së qëndrueshme (të pa lëvizshme)** - një pajtimtar i telefonisë së qëndrueshme mund të mbajë numrin e tij/saj të telefonit kur ai/ajo dëshiron të përfundojë një kontratë me një ofrues të caktuar dhe të nënshkruajë një kontratë me një ofrues tjetër të shërbimit telefonik të qëndrueshëm. Numrat e telefonisë së qëndrueshme mund të barten vetëm brenda një qarku ose vetëm brenda shtetit.
 - Numrat e telefonisë së qëndrueshme **NUK MUND** të barten tek rrjetet e telefonisë së lëvizshme, apo e anasjellta.
- Pasi të përfundoni plotësimin e kërkesës dhe formularit, procesi për bartjen e numrit do të udhëhiqet nga Abissnet (operatori Marrës). Abissnet është përgjegjës për dërgimin e kërkesës për bartje të pajtimtarit, tek Operatori Dhënës (operatori juaj aktual) dhe ndjekjen e procesit të bartjes së numrit.
- Në rast të refuzimit të kërkesës për bartje, Abissnet do t’ju njoftojë menjëherë për refuzimin e kërkesës, arsyet e refuzimit si dhe alternativat e korrigjimit të gabimeve, për kryerjen me sukses të bartjes.



- Në rastin e miratimit të kërkesës tuaj për bartjen e numrit, Abissnet do t'ju njoftojë për kryerjen me sukses të bartjes së numrit në rrjetin e Abissnet.

Sa kohë më duhet për bartjen e numrit ?

Proçesi i bartjes nuk mund të zgjatë – në kushte normale, më shumë se **3 ditë pune**.

Numri juaj do të bartet jo me shpejt se ditën e tretë të punës, duke i llogaritur nga dita e plotësimit dhe dorëzimit të kërkesës së bartjes së numrit. Ju do të caktoni datën e saktë me operatorin e zgjedhur.

Ku dhe si mund të gjej mbrojtje?

Për çdo ankesë në lidhje me portabilitetin e numrit, mund t'i drejtoheni:

- Abissnet, nëpërmjet emailit, telefonit, letër ose paraqitjes direkte në pikat e shitjes Abissnet, si më poshtë:

email: kujdesi@abissnet.al

Tel: + 355 44 300 001

Adresa: Rruga “Ismail Qemali”, Pallati 18, Kati II, Tiranë

- AKEP, nëpërmjet emailit, telefonit, letër ose paraqitjes direkte në zyrat e AKEP, si më poshte:

email: portabiliteti@akep.al

Tel : +355 4 2250928 (gjatë orarit zyrtar)

Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Tiranë